



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**NJOFTIM**

Në mbledhjen e datës 22 qershor 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mori vendimet që vijojnë:

U miratua kërkesa e shoqërisë “SPV BLUE 3” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

U miratua kërkesa e shoqërisë “5GX ENERGY” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 MW.

U zgjat afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s lidhur me kërkesën e shoqërisë “ERSEKA SOLAR PARK 1” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 MW.

U zgjat afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s lidhur me kërkesën e shoqërisë “ERSEKA SOLAR PARK 2” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 MW.

Në kuadër të çështjeve të tjera, u trajtua informacioni mbi kërkesën e shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 MW.

Gjithashtu, u trajtua informacioni mbi kërkesën e FSHU sh.a. për interpretim lidhur me procedurat e ndryshimit të titullarit të kontratës së furnizimit me energji elektrike në rastet e trashëgimisë dhe bashkëpronësisë.

Vendimet e plota publikohen në faqen zyrtare të ERE-s dhe në Fletoren Zyrtare.